REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot **Tiranë, më ___.___2019**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për**:** **"SHPRESA" SHPK**
Adresa: Rruga "Franc Josef Straus", Lezhë.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim"

Numri i referencës së procedurës: **REF-26378-06-13-2019**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë"**, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me fond të marrëveshjes kuadër: **7,499,732.15** (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme *(jo):* Buletini i Njoftimeve Publike *data 17.06.2019, Nr. 24.*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1) "NELSA" SHPK **J71601012S**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***

Vlera: **6,861,649** (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e

nëntë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

2) **"DAJTI PARK 2007" SHPK** **K11507003S**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***

Vlera: **6,142,024** (gjashtë milion e njëqind e dyzet e dy mijë e njëzet e katër) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

3) **"SHPRESA" SHPK** **K67917301H**
Emri i plotë i shoqërisë ***numri i NIPT-it***

Vlera: **7,219,170** (shtatë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1) **Arsyet e skualifikimit të "NELSA" SHPK me ofertë 6,861,649 lekë pa TVSH**

- *Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik, për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 4.1, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listë pagesat për periudhën e kërkuar mars-maj 2019 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës së lartpërmendur, (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetësorë, diplomë ose certifikatë kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuara me ato të kërkuara në dokumentet e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listë pagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 10 persona të kërkuar si ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, kuzhinier, mercelog/kimist/teknolog dhe shofer, të rregullt sipas listë pagesës (kodit) janë vetëm 8 persona.*

2) **Arsyet e skualifikimit të "DAJTI PARK 2007" SHPK me oferte 6,142,024 lekë pa TVSH**

- *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 7 të DT-së pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në mënyrë elektronike nuk ka paraqitur listë pagesat (E-SIG 025) të konfirmuara nga administrata tatimore për periudhën prill dhe maj 2019.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori ekonomik **“SHPRESA” SHPK**, me nr. NIPT K67917301H me ofertë ekonomike me vlerë: **7,219,170** (shtatë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë (pa TVSH) , me adresë: Rruga “Franc Josef Straus”, Lezhë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Tel: 042 247 865, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2019

Ankesa: PO

Ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor me Vendimet nr.1272/2Prot., datë 12.07.2019 dhe nr.1283/1Prot., datë 15.07.2019.

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM